



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

DREJTORIA TEKNIKE

[Dt.30.08.2024]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË
MARRËVESHJEN KUADËR (PARAPRAK)**

Operatorit Ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION ” shpk

Adresa: Tirane Kashar Autostrada Tirane - Durres, Km.10

Procedura e prokurimit/lotit: **Proçedurë e hapur** (marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues).

Numri i procedurës/referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: Loti III "Blerje letër", me Nr. REF-12945-07-11-2024 për nevoja të Autoriteteve Kontraktore përfituese Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Akademia e Forcave të Armatosura.

Kohëzgjatja e kontratës/marrëveshjes kuadër ose afati për zbatimin e saj: Deri në 24 muaj nga data e nënshkrimit të marrëveshjes kuadër. Lëvrimi/dorëzimi i mallit për lotin e tretë do të bëhet brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës/kontratave brenda marreveshjes kuader nga Autoritetet kontraktore përfituese.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini Nr. 37 datë 15 Korrik 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

• **Operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k**

NUIS J62426002Q

Vlera e ofertës pa tvsh = 4,296,996.99 (katër milion e dyqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëqdhjetë e gjashtë pikë nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k,** **NUIS K81503063B**

Vlera e ofertës pa tvsh = 5,779,137.17 (*pesë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë pikë shtatëmbëdhjetë*) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k,** **NUIS L91418502J**

Vlera e ofertës pa tvsh = 4,456,350 (*katër milion e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë*) lekë pa TVSH.

- **Operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k** **NUIS J72124001N**

Vlera e ofertës pa tvsh = 5,750,155 (*pesë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë*) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë s’kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k,** **NUIS L91418502J**

Për arsyet e mëposhtme:

Nga përlllogaritja rezultoi se oferta ekonomike me vlerë 4,456,350 (katër milionë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, paraqitur nga operatori ekonomik “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k. me NUIS L91418502J është anomalisht e ulët.

Në këto kushte, referuar në parashikimet e pikës 5, të nenit 93 të ligjit nr. 162/2020 të ndryshuar, cituar:

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët, Oferta e paraqitur nga OE “LIBRARI DYRRAHU” sh.p.k. me NUIS L91418502J do të refuzohet.

- **Operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k** **NUIS J62426002Q**

Për arsyet e mëposhtme:

Operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k. me NUIS J62426002Q s’kualifikohet për shkak se me shkresën datë 08.08.2024, të ngarkuar në SPE, ky operator është tërhequr nga pjesëmarrja në procedurë (shkresa e tërheqjes e administruar në dosjen e procedurës së prokurimit).

Duke iu referuar procedurës së mësipërme meqënëse procedura është marrëveshje kuadër me disa operatorë ekonomikë, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, **ku për çdo lot do të përcaktohet një operator ekonomik fitues** ju informojmë se operatori ekonomik i mëposhtëm i identifikuar si fitues (paraparak) i procedurës së prokurimit është:

- **Operatori ekonomik “MARKETING & DISTRIBUTION” sh.p.k NUIS J62426002Q**

Vlera e ofertës pa tvsh = 5,750,155 (*pesë milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë*) lekë pa TVSH.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.